

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML-Kzz-34/2015
2 qershor 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si kryetare e kolegjit, gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga këshilltari ligjor i EULEX-it Adnan Isufi në cilësi të procesmbajtësit, në procedurën penale kundër të pandehurve:

B.G., emri i babait B., emri i nënës P.S., i lindur më ***** në *****, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), mashkull, me banim në *****, rruga kryesore nr. ***, ish politikan, i vejë, baba i dy fëmijëve, ka shkollim universitar, Serb i Kosovës,

i dënuar në shkallë të parë me katër (4) vjet burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë dy (2) vjeçare sipas aktgjykimit nr. P-200/10 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 28 shkurt 2013 për kryerje të veprave penale të Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim të nenit 339 par 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) siç përcaktohet me nenin 442 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-Ligji nr 04/L-082), Mashtrimi në detyrë në shkelje të nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, siç përcaktohet me nenin 426 par 1 dhe 2, në lidhje me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së, (pikën 6), të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 943/13, të datës 25 gusht 2014, me të cilin i pandehuri B.G. dënohet me tre (3) vjet burgim për veprat penale të Mashtrimit në detyrë në shkelje të nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, siç përcaktohet me nenin 426 par 1 dhe 2, në lidhje me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së.

N.V., emri i babait N., emri i nënës R.P., i lindur më ***** në *****, me banim në *****, *****, ish ministër i shëndetësisë deri në *****, me shkollim të mesëm, i martuar, baba i një fëmije, Serb i Kosovës,

i dënuar me tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë dy (2) vjeçare sipas aktgjykimit nr. P-200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 28 shkurt 2013 për kryerje të veprave penale të Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim të nenit 339 par 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) siç përcaktohet me nenin 442 (1) të KPRK-së,

Mashtrimi në detyrë në shkelje të nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, siç përcaktohet me nenin 426 par 1 dhe 2, në lidhje me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së, (pikën 6), të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 943/13, të datës 25 gusht 2014, me të cilin i pandehuri N.V. dënohet me tre (3) vjet burgim për veprat penale të Mashtrimit në detyrë në shkelje të nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, siç përcaktohet me nenin 426 par 1 dhe 2, në lidhje me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së.

Duke vepruar lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 21 tetor 2014, të paraqitur nga avokati mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit B.G., të cilën Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar më 11 tetor 2014, Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 27 tetor 2014, të paraqitur nga avokati mbrojtës R.G. në emër të të pandehurit N.V., të cilën Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar më 27 tetor 2014, dhe lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i pandehuri B.G., të cilën Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar më 3 mars 2015, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P nr 200/2010 të datës 28 shkurt 2013, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR nr 943/13 të datës 25 gusht 2014.

Pas shqyrtimit të mendimeve nga Prokuroria e Shtetit të Kosovës të paraqitur më 6 shkurt 2015 dhe përkatësisht më 25 mars 2015,

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 2 qershor 2015, në përputhje me nenet 432, 433, 434 dhe 437 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-së), Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e avokatit mbrojtës B.T. në emër të të pandehurit B.G., Kërkesa /Plotësim kërkesa e paraqitur nga i pandehuri B.G. dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e avokatit mbrojtës R.G. në emër të të pandehurit N.V., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P nr 200/2010 të datës 28 shkurt 2013, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR nr 943/13 të datës 25 gusht 2014, refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës:

1. Më 2006, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e Kosovës (ZAP) ka zhvilluar një auditim për vitin 2005 në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim të Kosovës. Auditimi zbuloi parregullsi të shumta dhe shtrirje të madhe mospërputhjeshe me ligjet dhe rregulloret

relevante të specifikuara në Ligjin për Prokurimin Publik. Kur Zëvendësi i Parë i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (UNMIK-ZPPSSP), kërkoi transferimin e 1.1 milion eurove nga Ministria e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), doli se kjo shumë, e cila në letër ishte në buxhetin e Ministrisë, mungonte. Ministria raportoi se 1.1 milion eurot ishin shfrytëzuar për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive të pakicave refugjatë të kthyer në Kosovë. Megjithatë, Njësiti i Policisë për Hetime të Krimeve Ekonomike dhe Sektori për Hetimin e Korrupsionit nuk gjeti asnjë renovim apo ndërtim në kontrata të shumta të përfunduara nga kontraktuesit e angazhuar nga Ministria.

2. Më 6 gusht 2010, pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzën nr PP-58/2010 pranë (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër njëmbëdhjetë individëve, përfshirë edhe të pandehurit në këtë procedurë penale me mjet të jashtëzakonshëm juridik.
3. Prokurori i akuzoi të pandehurit në këtë çështje për kryerje të pretenduar të këtyre veprave penale:
 - a. Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të nenit 339 par 2 të KPK-së, vepër tani e dënueshme me nenin 422 të KPRK-së (pika 2, në bashkëkryerje kundër të pandehurit B.G. dhe pika 3 kundër të pandehurit N.V.);
 - b. Përvetësimi në detyrë, në kundërshtim të nenit 23, nenit 107 dhe nenit 340 paragrafëve 1 dhe 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 425 të KPRK-së (pika 4 në bashkëkryerje kundër të gjithë të pandehurve);
 - c. Përvetësimi, në kundërshtim të nenit 23, nenit 257 paragrafëve 1 dhe 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 330 të KPRK-së (pika 5, në bashkëkryerje kundër të gjithë të pandehurve);
 - d. Mashtrim në detyrë, në kundërshtim të nenit 23, nenit 107 paragrafit 1 dhe nenit 341 paragrafëve 1 dhe 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 31, 120 paragrafin 1 dhe nenin 426 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së (pika 6, në bashkëkryerje kundër të gjithë të pandehurve);
 - e. Marrja e ryshfetit, në kundërshtim të nenit 343 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 428 të KPRK-së (pika 7 kundër N.V.);
 - f. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare, në kundërshtim të nenit 23 dhe nenit 348 paragrafit 2 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 434 të KPRK-së (pika 9 në bashkëkryerje kundër të gjithë të pandehurve);
 - g. Falsifikimi i dokumenteve, në kundërshtim të nenit 23 dhe nenit 332 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me

nenin 398 të KPRK-së (pika 10, në bashkëkryerje kundër të gjithë të pandehurve).

4. Aktakuza është konfirmuar në tërësi me anë të aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 7 shkurt 2011¹.
5. Gjykimi ka filluar më 18 nëntor 2011 dhe ka vazhduar me 39 seanca gjatë tërë vitit 2012 dhe fillim vitit 2013.
6. Prokurori i PSRK-së ndryshoi aktakuzën disa herë, përkatësisht më 9 dhjetor 2011, 13 prill 2012 dhe përfundimisht më 21 nëntor 2012. Në fjalën e tij përmbyllëse, prokurori e tërhoqi akuzën për dhënie të ryshfetit kundër të pandehurit R.P (pika 8), dhe akuzat për bashkëkryerje për falsifikim të dokumenteve zyrtare dhe për bashkëkryerje për falsifikim të dokumenteve kundër të njëmbëdhjetë të akuzuarve (pika 9 dhe 10) për shkak të parashkrimit dhe akuzën për marrje të ryshfetit kundër të pandehurit N.V. (pika 7).
7. Më 28 shkurt 2013, gjykata e shkallës së parë shpalli aktgjykimin. Gjykata e shkallës së parë i refuzoi pikat 7, 8, 9 dhe 10 të aktakuzës (të cilat prokurori i kishte tërhequr) dhe i liroi të gjithë të pandehurit nga pikat 4 dhe 5 të aktakuzës.
8. Sa i përket të pandehurit B.G., gjykata e shkallës së parë e shpalli atë fajtor për pikën 2, Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së dhe për pikën 6, për bashkëkryerje në mashtrim në detyrë nga neni 23, 107 dhe 341 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së. I pandehuri B.G. u dënua me dy (2) vjet burgim për pikën 2 dhe me tre (3) vjet burgim për pikën 6. Rrjedhimisht, gjykata e dënoi të pandehurin B.G. me një dënim unik me katër (4) vjet burgim. B.G. është dënuar edhe me dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë dy (2) vjeçare.
9. Sa i përket të pandehurit N.V., gjykata e shkallës së parë e shpalli atë fajtor për pikën 3, Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së dhe për pikën 6, për bashkëkryerje në mashtrim në detyrë nga neni 23, 107 dhe 341 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së. I pandehuri N.V. u dënua me dy (2) vjet burgim për pikën 3 dhe me tre (3) vjet burgim për pikën 6. Rrjedhimisht, gjykata e dënoi të pandehurin N.V. me një dënim unik me tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim. N.V. është dënuar edhe me dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë dy (2) vjeçare.

¹ Aktvendimi KA nr 185/2010.

10. Të gjithë të akuzuarit janë obliguar t'i mbulojnë shpenzimet e procedurës në shumën e përcaktuar prej 3.000 Eurosh.
11. Më 25 gusht 2014, Gjykata e Apelit vendosi lidhur me ankesën e paraqitur nga PSRK-ja dhe ankesat e mbrojtjes, përfshirë edhe ankesat e paraqitura në emër të të pandehurve në këtë procedurë penale.
12. Gjykata e Apelit e hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga PRSK-ja si të palejueshme duke u bazuar në nenin 400 paragrafit (2) të KPP-së.²
13. Sa i përket të pandehurit B.G., Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e apeluar të gjykatës së shkallës së parë lidhur me akuzën për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit (pika 2). Gjykata e Apelit pohon se akuza për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit nga neni 339 paragrafi 3 i KPK-së, e dënueshme me nenin 442 (1) të KPRK-së, është konsumuar në veprat penale të mashtrimit në detyrë në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 341 (1) dhe (3) lidhur me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, e dënueshme me nenin 426 par 1 dhe 2, lidhur me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së (pika 6). Dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të pandehurit B.G. u ndryshua në tre (3) vjet burgim për veprat penale të mashtrimit në detyrë në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 341 (1) dhe (3) lidhur me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, e dënueshme me nenin 426 par 1 dhe 2, lidhur me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së.
14. Sa i përket të pandehurit N.V., Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e apeluar të gjykatës së shkallës së parë lidhur me akuzën për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit (pika 2). Gjykata e Apelit pohon se akuza për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit nga neni 339 paragrafi 3 i KPK-së, e dënueshme me nenin 442 (1) të KPRK-së, është konsumuar në veprat penale të mashtrimit në detyrë në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 341 (1) dhe (3) lidhur me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, e dënueshme me nenin 426 par 1 dhe 2, lidhur me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së (pika 6). Dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të pandehurit N.V. u ndryshua në tre (3) vjet burgim për veprat penale të mashtrimit në detyrë në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 341 (1) dhe (3) lidhur me nenin 23 dhe nenin 107 par 1 të KPK-së, e dënueshme me nenin 426 par 1 dhe 2, lidhur me nenin 31, nenin 120 par 2 nën-par 1 të KPRK-së.

² Në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012.

15. Gjykata e Apelit e hoqi obligimin e të gjithë të akuzuarve për kompensimin e shpenzimeve të procedurës.
16. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar të pandehurit B.G. më 7 nëntor 2014 dhe të pandehurit N.V. më 30 tetor 2014.
17. Më 11 nëntor 2014, avokati mbrojtës B.T. paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit B.G. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
18. Më 27 tetor 2014, avokati mbrojtës R.G., paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit N.V. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
19. Më 11 shkurt 2015, Prokuroria e Shtetit paraqiti përgjigje ndaj kërkesave të avokatëve mbrojtës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke i propozuar gjykatës që t'i refuzojë ato si të pabazuara.
20. Më 3 mars 2015, Gjykata Supreme e Kosovës pranoi një plotësim kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i pandehuri B.G. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
21. Më 25 mars 2015, Prokuroria e Shtetit paraqiti përgjigje ndaj plotësim kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i pandehuri B.G., duke i propozuar gjykatës që ta hedhë poshtë këtë kërkesë si të paafatshme ose përndryshe ta refuzojë si të pabazuar.

II. Parashtrësit e palëve

22. Avokati mbrojtës B.T. thirret në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 të KPP-së) dhe në shkelje të ligjit penal (neni 385 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 i KPRK-së). Avokati mbrojtës B.T. propozon ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe lirim të të pandehurit nga akuzat ose si alternativë anulimin e të dy aktgjykimeve të apeluara dhe kthimin e lëndës në Gjykatën Themelore të Prishtinës në rigjykim.
23. Avokati mbrojtës B.T. argumenton se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit lidhur me dënimin e të pandehurit B.G. për veprën penale të mashtrimit në detyrë të kryer në bashkëkryerje është i pakuptueshëm. Avokati mbrojtës B.T. pretendon se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka arritur në përfundim se i pandehuri B.G. i ka kryer veprat e pretenduara penale në bashkëkryerje. Për kryerjen e këtij krimi në bashkëkryerje

kërkohej një plan paraprak, që krimi i planifikuar të kryhet nga të pandehurit dhe që krimi duhet të pranohet nga secili bashkëkryerës. Sipas avokatit mbrojtës, gjykata e shkallës së parë është mbështetur tepër në nenin 107 të KPK-së. Përveç kësaj, avokati mbrojtës parashtron se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i kundërshton dëshmitë e Z. M., R. B. dhe M. V. Avokati mbrojtës pohon se fajësia e B.G.-it nuk është mbështetur me asnjë provë. Avokati mbrojtës argumenton se edhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i pakuptueshëm pasi që në njërën anë e refuzon akuzën për Shpërdorim të pozitës zyrtare dhe në bazë të veprimeve të njëjta shpall fajtor të pandehurin për veprën penale mashtrim në detyrë në bashkëkryerje.

24. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Avokati mbrojtës R.G. thirret në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 432 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 të KPP-së) dhe në shkelje të ligjit penal (neni 432 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 i KPRK-së). Avokati mbrojtës R.G. propozon ndryshimin e dy aktgjykimeve të apeluara dhe lirim të të pandehurit N.V. nga dënimi ose kthimin e lëndës në rigjykim.
25. Avokati mbrojtës R.G. pretendon se i pandehuri N.V. nuk ka pasur asnjë lidhje me Departamentin e Financave brenda Ministrisë. Avokati mbrojtës i referohet dëshmisë së M.A., Drejtor i departamentit për buxhet dhe financa i cili gjoja ka deklaruar se të gjitha pagesat janë bërë përmes zyrës së tij kurse kontratat janë përpiluar nga Zyra ligjore. Sipas mbrojtjes, sapo komisioni për kthim ka vendosur lidhur me përfituesin, rasti është përcjellë nga administrata te zyra e prokurimit dhe pastaj tek zyra e financave. I njëjti dëshmitar ka sqaruar se ligji në fuqi në atë kohë ka lejuar që pagesa të bëhet paraprakisht. Kontratat vlera e të cilave nuk ka tejkalluar 10.000 Euro kanë shkuar përmes procedurës më të thjeshtë. Përmbushja e kontratave është përcjellë nga komisioni i Ministrisë. Avokati mbrojtës R.G. gjithashtu përmend provat e T.G., zyrtares së buxhetit. Avokati mbrojtës pohon se i pandehuri N.V. nuk ka qenë i autorizuar që të bëjë pagesa, prandaj, akuza për mashtrim në detyrë është e pabazuar dhe e pavërtetuar. Avokati mbrojtës pohon se asnjë provë materiale nuk vërteton se i pandehuri N.V. ka pranuar para në mënyrë të kundërligjshme, ka përfituar nga veprimet e tij apo ka dëmtuar Ministrinë. Avokati mbrojtës R.G. përsërit se N.V. nuk ka qenë i përfshirë në këtë proces para dhe pas nënshkrimit të kontratës si rezultat i procedurës së prokurimit. Sipas avokatit mbrojtës, edhe po të kishte dashur nuk do të mund të kishte qasje në veprimet jashtë zyrës së prokurimit. Sidoqoftë, dashja e tij nuk është vërtetuar me prova dhe prandaj aktgjykimet e apeluara kanë shkelur ligjin penal. Ngjashëm, ai nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet e komisionit për verifikim i cili ka

qenë nën mbikëqyrjen e Sekretarit permanent. Përfundimisht, avokati mbrojtës pretendon se bashkëkryerja nuk është vërtetuar.

26. Prokurori i shtetit pohon se të dy avokatët mbrojtës vetëm i kanë ri-dorëzuar argumentet e tyre në Gjykatën Supreme të cilat janë shqyrtuar dhe refuzuar nga Gjykata Themelore gjatë gjykimit dhe nga Gjykata e Apelit në procedurën e apelit. Prokuroi thekson se përveç mospajtimit me gjetjet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, asnjëri avokat mbrojtës nuk ka demonstruar se provat në të cilat është bazuar gjykata nuk do të mund të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktit apo që vlerësimi i provave është jo logjik dhe i gabuar. Prokurori gjithashtu pohon se nuk mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së.
27. I pandehuri B.G. në kërkesën e tij pohon se rasti është bazuar në dokumente dhe dëshmi të rreme të dëshmitarëve dhe kërkon që lënda të kthehet në rigjykim. I pandehuri B.G. paraqet kundërshtimet e tij kundër aktakuzës, kundër Prokurorit special i cili ndjek rastin dhe kundër lirimit të të pandehurit S. P. dhe përsërit mbrojtjen e tij duke paraqitur pikëpamjet e tij lidhur me faktet e lëndës.
28. Më 25 mars 2015, Prokuroi i Shtetit i Kosovës ka paraqitur mendimin e tij në lidhje me kërkesën e të pandehurit B.G. duke theksuar se kërkesa është e papranueshme sepse është e paafatshme dhe nuk i përmbush kushtet ligjore të nenit 376 paragrafit 1 nën-paragrafëve 1.5 dhe 1.7 të KPP-së pasi që nuk specifikon bazën ligjore për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 432 paragrafit 1 të KPP-së apo përsëritimin e bazës ligjore për mjetin juridik. Më tutje, prokurori pohon se edhe nëse kërkesa është paraqitur me kohë, ajo nuk është mbështetur.

III. Procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës:

29. Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur lidhur me kërkesat [Neni 432 (1) i KPP-së].
30. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancën e këshillimit dhe votimit. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk ka qenë i nevojshëm.

IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

31. Së pari, gjykata ka shqyrtuar në paraqitësit e kërkesave janë palë të autorizuar për të paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pranë gjykatës, në pajtim me kushtet e KPP-së.

Përkitazi me këtë, neni 432 i KPP-së përcakton:

1. *Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:*
 - 1.1. *në rast të shkeljes së ligjit penal;*
 - 1.2. *në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose*
 - 1.3. *në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.*
2. *Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*
3. *Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.*

Më tutje, neni 433 i KPP-së përcakton:

1. *Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, I pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1, fjalia e fundit e këtij Kodi.*
2. *Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.*
3. *Kur me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rrjedh nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i dorëzohet të pandehurit.*

4. *Pavarësisht nga dispozitat e nenit 432, paragrafi 2. i këtij Kodi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga paragrafi 3. i këtij neni mund të paraqitet edhe kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.*
32. Lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së të pandehurit B.G., kolegji vëren se në bazë të shkresave të lëndës, i pandehurit i është dorëzuar aktgjykimi i apeluar i Gjykatës së Apelit më 7 nëntor 2014. I pandehuri B.G. ka paraqitur kërkesën shtesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 3 mars 2015. Prandaj, kërkesa e B.G. është paraqitur pas afatit të përcaktuar prej tre muajve sipas nenit 433 par. 2 të KPP-së. Sidoqoftë, kolegji vëren se avokati mbrojtës B.T. i cili e përfaqëson atë ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 11 tetor 2014, e cila është bërë brenda afatit të përcaktuar. Prandaj, kolegji konsideron kërkesën e paraqitur nga B.G. si plotësim i kërkesës fillestare për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati i tij mbrojtës, dhe si e tillë, do të konsiderohet e pranueshme.
33. Lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës B.T. në emër të pandehurit B.G. dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të avokatit mbrojtës R.G. në emër të pandehurit N.V., kolegji gjen se të dyja janë paraqitur brenda afatit të përcaktuar, siç është përcaktuar me nenin 435 të KPP-së. Kolegji, gjithashtu gjen se kërkesat e lartpërmendura për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur nga personi i autorizuar, siç është përcaktuar me nenin 433 *ibid*, dhe kundër aktgjykimit të formës së prerë, sipas nenit 434 *ibid*. Rrjedhimisht, ato janë të pranueshme.

IV. Meritat e kërkesave

34. Së pari, gjykata do të elaboroj kërkesën e avokatit mbrojtës B.T. dhe të pandehurit B.G. dhe pastaj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të avokatit mbrojtës R.G. në emër të pandehurit N.V..
35. Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asnjë gabim procedural në aktgjykimet e kundërshtuara që do të duhet të merret parasysh sipas detyrës zyrtare. Prandaj, sipas dispozitave të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet në shqyrtimin e vetëm atyre shkeljeve të ligjit të cilat janë pretenduar nga pala e cila ka paraqitur kërkesë.
36. Gjykata Supreme e Kosovës gjen të gjitha kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të pabazuara.
37. Duke iu referuar pretendimeve të avokatit mbrojtës B.T. se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në lidhje me dënimin e të pandehurit B.G. për veprën penale Mashtrim në

detyrë të kryer në bashkëkryerje është i pakuptueshëm; kolegji gjen se argumenti i mbrojtjes është i pa meritë. Kolegji pajtohet me mbrojtjen se Gjykata e Apelit gjatë ndryshimit të dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë gabimisht ka përdorë termin “hedh poshtë”. Sidoqoftë, ky është një gabim gjuhësor i cili nuk ndikon në vlefshmërinë e aktgjykimit. Kolegji gjen se nuk ka asnjë dyshim se Gjykata e Apelit nuk i ka liruar të pandehurit për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare apo i autorizimit nga neni 339 par. 3 i KPK-së, e dënueshme me nenin 442 (1) të KPRK-së, siç pretendohet nga mbrojtja. Siç është sqaruar në arsyetimin e aktgjykimin e GjA-së, Gjykata e Apelit ka gjetur, me të cilat ky kolegji pajtohet plotësisht, se vepra penale Shpërdorim i pozitës zyrtare apo i autorizimit nga neni 339 par. 3 i KPK-së, e dënueshme me nenin 442 (1) të KPRK-së është konsumuar nga vepra penale Mashtrim në detyrë e kryer në bashkëkryerje sipas nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 dhe nenin 107 par. 1 të KPK-së, e dënueshme me nenin 426 par. 1 dhe 2, lidhur me nenin 31, nenin 120 par. 2 nën-par. 1 të KPRK-së, (pika 6). Kolegji mendon se Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të duhura dhe të mjaftueshme përkitazi me këtë. Më tutje, kolegji gjithashtu vëren se jo vetëm që dispozitivi është i qartë se njëra vepër penale ka konsumuar tjetrën, prandaj ka konsideruar se i nënshtrohet njërës akuzë, por më e rëndësishmja është se kjo gjetje shkon në dobi të pandehurit, e që si rezultat i kësaj i bënë argumentet e avokatit mbrojtës të pakuptimta. Siç është vërejtur tanimë, vetëm përdorimi i gabuar i termit “hedh poshtë” nga Gjykata e Apelit në lidhje me këtë mund të konsiderohet si gabim gjuhësor i cili në asnjë mënyrë nuk e bën aktgjykimin e ankimuar të pakuptueshëm.

38. Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se përfundimet e gjykatave janë në kundërtënie me deklaratat e ndryshme të dëshmitarëve, kolegji vëren se këto argumente nuk janë mbështetur. Kolegji vëren se, në parim, shqyrtimi i Gjykatës Supreme në këtë fazë të procedurës i mjetit të jashtëzakonshëm juridik është i kufizuar në vlerësimin e ligjshmërisë. Vërtetimi i gjendjes faktike mund të kontestohet në rrethana të jashtëzakonshme p.sh. nëse dhe kur paraqiten prova relevante të cilat tregojnë se gjendja e vërtetuar faktike dhe provat në të cilat është bazuar gjykata janë tërësisht apo në masë të madhe të gabuara. Në këtë lëndë, avokati mbrojtës vetëm pohon se ka kundërtënie. Kolegji thekson se, kur pretendohet në kundërtënie të aktgjykimit apo të dispozitivit të tij, nuk mjafton që të përsëritet formulimi i dispozitave përkatëse të KPP-së në mënyrë mekanike. Avokati mbrojtës nuk duhet vetëm të tregojë se ekziston kundërtënia, për shembull në mes të dispozitivit dhe aktgjykimit apo në mes të arsyetimit dhe fakteve të vërtetuara gjatë gjykimit, por gjithashtu duhet të sqarojë se ku qëndron kundërtënia apo pse nuk janë në përputhje faktet me

përshkrimin e tyre në vendim. Deklarimi i thjeshtë sikur në këtë rast se ka kundërthënie nuk përbën arsye të mjaftueshme e as nuk i ndihmon gjykatës që ta kuptojë argumentin e avokatit mbrojtës. Prandaj, kolegji gjen argumentin e mbrojtjes në lidhje me këtë të pa meritë.

39. Kolegji gjithashtu nuk pajtohet me avokatin mbrojtës B.T. se ekzistimi i planit është parakusht për përmbushjen e elementeve të veprës penale Mashtrim në detyrë të kryer në bashkëkryerje. Mbi këtë pikë, për kolegjin mjafton të thuhet se deri më tani është vërtetuar me prova relevante të administruara në mënyrë të duhur nga gjykata se secili i pandehur ka kontribuar në njëfarë mënyre dhe ka pasur për qëllim kryerjen e veprës penale, që është e mjaftueshme për qëllime të bashkëkryerjes.
40. Lidhur me pretendimin e avokatit mbrojtës R.G. se i pandehuri N.V. nuk ka pasur asnjë lidhje me Departamentin e financave në kuadër të Ministrisë, se dëshmitari M.A., ka konfirmuar se të gjitha pagesat janë bërë përmes zyrës së tij dhe kontratat janë përpiluar nga Zyra ligjore dhe se i pandehuri N.V. nuk ka qenë i autorizuar që të bëjë pagesa etj., Gjykata Supreme e Kosovës gjen se edhe pse avokati mbrojtës nuk e pohon shprehimisht, këto argumente në mënyrë indirekte kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike. Siç është cekur më lart, kolegji përsërit se sipas KPP-së nuk është detyrë e tij që të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e faktit. Është detyrë e gjykatave të faktit që të interpretojnë dhe zbatojnë në mënyrë primare rregullat përkatëse të ligjit të procedurës dhe material. Gjykata Supreme në procedurën e mjetit të jashtëzakonshëm juridik duhet të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe nëse procedura në përgjithësi, shikuar në tërësi, është zhvilluar në atë mënyrë që pala të ketë pasur një gjykim të drejtë. Prandaj, kolegji konsideron se mbrojtja nuk i ka mbështetur pretendimet e tij e as nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* e cila tregon në shkelje të të drejtave të tij sipas ligjit. Rrjedhimisht, kolegji konsideron se argumentet e paraqitura nga avokati mbrojtës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të dispozitave të kodeve të procedurës dhe atij penal.
41. Lidhur me argumentet se i pandehuri N.V. nuk ka qenë i autorizuar që të bëjë pagesa, dhe se nuk ka asnjë provë e cila tregon se i pandehuri N.V. ka pranuar para në mënyrë të kundërligjshme dhe/ose ka dëmtuar Ministrinë, kolegji gjen këto argumente të pabazuara. Në këtë kontekst, kolegji është i mendimit se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të plotë ka përmendur faktet të cilat i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë, dhe në mënyrë specifike ka treguar provat në të cilat është mbështetur

grykata gjatë marrjes së aktgjykimit. Pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së parë përmban të gjitha detajet dhe ofron sqarime të mjaftueshme të gjendjes faktike në bazë të provave të cilat janë marrë, administruar dhe vlerësuar në mënyrë të drejtë nga grykata. Prandaj, pretendimi i avokatit mbrojtës lidhur me mospërputhjen e aktgjykimit është i pabazuar.

42. Kolegji gjithashtu gjen të pabazuara argumentet se dispozitivi i aktgjykimit të Grykatës Themelore është në kundërthënie me dëshmitë e Z. M., R. B. dhe M. V., se dashja nuk është vërtetuar me anë të provave, se i pandehuri nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet e komisionit për verifikim i cili ka qenë nën mbikëqyrjen e Sekretarit permanent. Kolegji gjen se avokati mbrojtës ka dështuar të jap ndonjë elaborat se cili aspekt i dispozitivit është në kundërthënie me deklaratat në fjalë. Kolegji është i mendimit se grykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, ka paraqitur faktet të cilat janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe ka dhënë arsye të qarta dhe bindëse mbi vërtetimit e fakteve të rastit. Prandaj, nuk ka asnjë kundërthënie në dispozitivin e aktgjykimit, e as nuk ka ndonjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.
43. Sa i përket shkeljes së pretenduar të dispozitave të Kodit Penal, kolegji vëren se në këtë lëndë dispozitat e dy kodeve penale kanë qenë të zbatueshme. Si e tillë, në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm në një rast të caktuar para marrjes së vendimit të formës së prerë, siç ka ndodhë këtu, zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin. Duke krahasuar dispozitat përkatëse të dy Kodeve Penale relevante për këtë lëndë, kolegji nuk gjen ndonjë ndryshim të veçantë në mes të dy kodeve që do të ishte më i favorshëm për të pandehurit. Prandaj, kolegji nuk gjen asnjë shkelje të dispozitave të Kodit Penal.

Për këto arsye, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML-KZZ-34/2015
2 qershor 2015

Kryetare e kolegjit

Procesmbajtës:

Elka Filcheva-Ermenkova
Kryetare e kolegjit e EULEX-it

Adnan Isufi
Këshilltar ligjor i EULEX-it

Willem Brouwer
Gjyqtar raportues i EULEX-it

Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme